



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. 10 prot.

Kamëz, më 10.02.2021

V E N D I M

Nr. 09.Datë 10 .02.2021

P Ë R

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SHITJEN NË ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT “F.K KAMZA” NË MASËN 49% QË ZOTËROHEN NGA BASHKIA KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **10.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.10 Datë 05.02.2021**, në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”; nënpika 1.2. shkronja “a”; nenit 54, gërma “e” të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 79/2017 “Për sportin”; nenit 8 të Ligjit 105/2020 “Për disa shtesa në dhe ndryshime në Ligjin 79/2017 për sportin; Vendim nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar; Ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”; Ligjit 9901, datë 14.01.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar: **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Dhënie e pëlqimit për shitjen në ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “F.K Kamza” në masën 49% që zotërohen nga Bashkia Kamëz;
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/Kryetar Këshilli

